



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 346/6 Prot.

Tiranë, më 12 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 191 , Datë 12 . 08 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 51 Regj., datë 28.02.2025, paraqitur nga znj. A. C dhe z. E. V³, kundër Shkollës së Mesme Industriale “Arben Broci”, Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminimin e djalit të tyre të mitur, O. V, i cili ndjek arsimin e mesëm profesional, pranë kësaj Shkolle, për shkak të “aftësisë së kufizuar⁴” .

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesën e depozituar pranë KMD-së, subjektet ankues informojnë se:

“Djali jonë O. V, aktualisht ndjek studimet në Shkollën Industriale “Arben Broci”, Shkodër. Që në fillim të vitit shkollor, Drejtori i kësaj Shkolle, është vënë në dijeni nga ne si prindër, përmes raportit mjekësor të djalit tonë, se ai është një nxënës me aftësi të kufizuara.

Ne si prindër, kemi kaluar një proces shumë të vështirë lidhur me njohjen e djalit tonë si fëmijë me aftësi ndryshe. Pavarësisht sfidave të shumta, në vitin 2017, kemi arritur të sigurojmë një

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Në cilësinë e prindërve të fëmijës O. V.

⁴ Referuar Vërtetimit të KMCAP i DRSSH Shkodër, O. V, i datëlindjes xxxxx, është diagnostikuar me “xxxxxxx”.

mësues ndihmës, i cili ka asistuar në procesin arsimor të O, duke e ndihmuar jo vetëm në nxënie, por edhe në ndjerjen e tij si të barabartë mes bashkëmoshatarëve të tjerë.

Në fillimin e vitit shkollor 2024-2025, kjo mundësi dhe e drejtë ligjore e fëmijës tonë është mohuar plotësisht, vetëm si pasojë e veprimeve e mosveprimeve të Drejtorit të Shkollës.

Pavarësisht se Shkolla është informuar zyrtarisht për nevojën e fëmijës tonë për një mësues ndihmës, si përmes sistemit e-Albania, ashtu edhe përmes takimeve të shpeshta të kërkuara nga ne si prindër, dhe që nga shtatori 2024, deri në shkurt 2025, nuk është marrë asnjë masë për t'i ofruar djalit tonë mbështetjen që i sigurohet me ligj.

Përveç shkëljes së hapur të detyrimeve ligjore, ky veprim ka ndikuar negativisht në rritjen dhe edukimin e fëmijës tonë, duke shkaktuar tek ai probleme të forta shpirtërore dhe sociale. Në vijim, të kësaj sjelljeje të papërgjegjshme, shpeshherë jemi telefonuar nga Shkolla për të shkuar urgjentisht atje, pa marrë parasysh angazhimet tona, vetëm për të menaxhuar situata të cilat, Shkolla vetë ka detyrimin t'i trajtojë përmes mësuesit ndihmës; sjellje e cila nuk është normale për një institucion arsimor.

Si pasojë e kësaj situatë, fëmija jonë është diskriminuar, duke mos marrë trajtimin e duhur sipas përcaktimeve ligjore, shpeshherë është tallur dhe vënë në lojë nga bashkëmoshatarët, për shkak të vështirësive që përjeton në mungesë të ndihmës së duhur.

Dëshirojmë të theksojmë se, si prindër, kemi zhvilluar takime të vazhdueshme (rreth 12 të tilla) me Drejtorin e Shkollës, z. L, por çdo herë kemi marrë vetëm justifikime dhe shmangie të përgjegjësive, me qëllimin e qartë për të mos kryer detyrën e tij ligjore.

Në datën 11.12.2024, në ambientet e Shkollës ka ndodhur një ngjarje shqetësuese për ne. Jam telefonuar nga mësuesja kujdestare e djalit e cila më ka raportuar për ngacmimin e O nga disa nxënës të tjerë në klasë, si pasojë e të cilës djali ka dalë nga ora e parë e mësimit, në lëndën e gjuhës shqipe. Kur kemi vajtur në Shkollë psikologu i Shkollës nuk ishte i pranishëm. Nisur nga ky episod, e kemi adresuar këtë ngjarje e problematikë pranë Drejtorit të Shkollës, personalisht, por edhe nëpërmjet e-mailit datë 11.12.2024, duke i kërkuar: emërimin e menjëhershëm të një mësuesi ndihmës për fëmijën tonë, në përputhje me detyrimet ligjore; ndërhyrjen e menjëhershme për të parandaluar çdo formë ngacmimi apo bullizmi nga nxënësit e tjerë dhe sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të përshtatshëm për mësim; përfshirjen e psikologut të Shkollës në situata të ngjashme për të ofruar mbështetjen emocionale dhe psikologjike për fëmijën.

Në muajin dhjetor 2024, në prani të disa personave të tjerë, Drejtori na premtoi se me fillimin e vitit të ri, do të vihej në dispozicion të O, mësuesi ndihmës.

Më datë 6 janar 2025, na kërkoi që të dorëzonim zyrtarisht një kërkesë me shkrim për caktimin e një mësuesi ndihmës për djalin tonë, kërkesë të cilën e kemi dorëzuar menjëherë, por për të cilën deri më sot nuk kemi marrë asnjë informacion lidhur me masat konkrete nga ana e Shkollës.

E vetmja gjë që kemi kuptuar nga Drejtori dhe personat përgjegjës është mungesa e vullnetit për zgjidhjen e problemit, duke injoruar kërkesat tona dhe duke diskriminuar hapur djalin, duke i mohuar të drejtën për t'u asistuar nga mësuesi ndihmës dhe duke e vënë atë në një situatë të vështirë arsimore, sociale dhe emocionale. Kërkojmë nga Komisioneri marrjen e masave dhe ndërhyrjen e tij urgjente për zgjidhjen e kësaj problematike.”

Subjektet ankues, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të fëmijës së tyre, O. V, vendosjen e një mësuesi ndihmës për të, si dhe marrjen e masave ligjore ndaj Shkollës për mosveprim dhe shkelje të të drejtave të fëmijës së tyre.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 346/3 prot., datë 05.03.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga ana e Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci”, Shkodër⁵, lidhur me pretendimin e palës ankuese.
- Në vijim të sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 3002/1 prot., datë 28.02.2025, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve

⁵ Shkresa u është dërguar për dijeni edhe: MEKI-t, AKPA-së, AKAFPK-së.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

Shoqërore, pranë MEKI-t, ka informuar Komisionerin si më poshtë vijon (*shkresa i drejtohet prindërve të fëmijës O. V, dhe për dijeni KMD-së, MAS-së dhe SPAK-ut*):

“...lidhur me problematikën e adresuar për situatën e djalit tuaj, sqarojmë se, kjo çështje është adresuar pranë MEKI-t, edhe nga Drejtori i Shkollës, dhe tashmë janë marrë masat për zgjidhjen e saj.

Konkretisht ju bëjmë me dije se, janë rishikuar strukturat e shkollave për vitin 2025, dhe në shkollën profesionale “Arben Broci”, Shkodër, është shtuar një mësues ndihmës për të asistuar djalin tuaj. Këto struktura janë dërguar për miratim dhe sapo të përfundojë procesi i miratimit të tyre, nga ana e Shkollës do të vijohet me procedurat për punësimin e tij.”.

2. Nëpërmjet shkresës me nr. 84 prot., datë 04.04.2025, Shkolla e Mesme Industriale “Arben Broci” Shkodër, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e saj, duke depozituar parashtrimet lidhur me pretendimet e prindërve të nxënësit O. V, si dhe ka b/lidhur dokumentacion shkresor. Në parashtrimet e saj, Shkolla, ndër të tjera, sqaron se:

“Së pari, Shkolla e Mesme Industriale “Arben Broci” nuk ka pasur më parë në historikun e saj nxënës me aftësi ndryshe. Nxënësi O. V përbën rastin e parë të regjistrimit në Shkollë, për të cilin jemi vënë në dijeni para fillimit të vitit shkollor 2024-2025 nga SMIP, si dhe nga mësuesja kujdestare e klasës së dhjetë TIK, znj. K. D. Rrjedhimisht përbën rastin e parë për të cilin Shkolla ka nevojë për një mësues ndihmës.

Duke qenë se për vitin shkollor 2023-2024 në Shkollën e Mesme Industriale “Arben Broci”, Shkodër, nuk ka pasur të regjistruar asnjë nxënës me aftësi të kufizuar, as në klasë të X-të dhe as në klasat e tjera më të larta, në strukturën organizative ekzistuese për vitin shkollor 2024-2025, kjo Shkollë nuk kishte mësues ndihmës.

Megjithatë, pas regjistrimit të nxënësit O. V në klasë të X-të për vitin shkollor 2024-2025, për të cilin nga ana e prindërve është dorëzuar raport mjekësor për aftësi të kufizuar, drejtoria e Shkollës ka depozituar në AKPA kërkesën për përfshirjen në strukturën e Shkollës të një mësuesi ndihmës, me qëllim ofrimin e mbështetjes për këtë nxënës.

Me Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 278, datë 28.02.2025, tashmë Shkollës i është miratuar një mësues ndihmës në strukturën organizative dhe është në proces rekrutimi sipas legjislacionit në fuqi.

Që nga fillimi i vitit 2024-2025, Shkolla ka siguruar që nxënësi të marrë mbështetjen e duhur dhe të përshtatshme për nevojat e tij përmes mësimdhënies së specializuar, mjediseve të aksesueshme, vënies në dispozicion të mjeteve dhe pajisjeve ndihmëse si dhe mbështetjes sociale dhe emocionale. Gjithë stafi drejtues, stafi mësimor dhe nxënësit e klasë X TIK, kanë qenë të gatshëm për të ndihmuar dhe ofruar mbështetjen e duhur sociale dhe emocionale.

Nxënësi ka pasur në dispozicion një tavolinë me laptop si dhe ka pasur akses në çdo ambient të shkollës për nevojat e tij.

Drejtuësi i shkollës është kujdesur që në marrëdhëniet e krijuara mes tyre të konsiderohej i afërt me të. Për çdo veprim të kryer nga ana e Drejtorisë së Shkollës janë vënë në dijeni prindërit e nxënësit si dhe të afërmit e tjerë që janë interesuar pranë Drejtorisë.

Në çdo moment që nxënësi ka pasur nevojë për asistencë janë gjendur pranë tre mësues të tjerë të cilët i kanë vënë në dispozicion laboratorët e tyre:

- Laboratori TIK – mësuesi J. H;
- Laboratori Elektronikës – mësuesi A. Sh;
- Laboratori Fizikës – mësuese K. D.

Së dyti; në lidhje me datën 11.12.2024, ngjarjet siç pretendojnë subjektet ankues nuk qëndrojnë ashtu, por janë zhvilluar si më poshtë vijon, gjë për të cilën ka dhe dëshmitarë:

Nga mësuesja kujdestare e lëndës gjuhë e huaj angleze, është paraqitur situata se nxënësi me aftësi ndryshe O. V ka kërkuar të shoqërohet në shtëpi nga prindi, pasi nuk ishte i qetë.

Pas njoftimit përkatës, prindërit janë paraqitur pranë Drejtorisë së Shkollës dhe kanë deklaruar se dy nxënës kanë ngacmuar djalin e tyre gjatë orës së mësimit, duke nxitur acarimin e tij përgjatë asaj ore.

Me qëllim sqarimin e situatës është zhvilluar një mbledhje me nxënësit e klasës së X TIK, të cilët pohuan se përdorimi i fjalës “sferë” nga dy nxënës të klasës ka acaruar përqendrimin e nxënësit me aftësi ndryshe. Në përfundim të mbledhjes, nxënësit u ndërgjegjësuam dhe reagueshan pozitivist në grup për të eliminuar çdo fjalë dhe gjest që mund të acarojë nxënësin O. V.

Gjatë muajit dhjetor janë zhvilluar disa herë takime me subjektin ankues znj. A. C për problemin e të birit dhe ka qenë gjithnjë e informuar mbi çdo zhvillim në drejtim të zgjidhjes së problemit.

Së treti, lidhur me emërimin e mësuesve ndihmës, theksojmë se, me Urdhrin nr. 278, datë 28.02.2025, të Ministrit të MEKI-t, tashmë Shkollës i është miratuar një mësues ndihmës në strukturën organizative.

Në vijim, Shkolla ka nisur menjëherë procedurat e rekrutimit të këtij mësuesi në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

Me datë 17.03.2025 është arritur të nëshkruhet marrëveshja me një mësues ndihmës sipas listave të dërguara nga ZVAP-ja me kandidatët e profileve të tjera, të cilët gjatë aplikimit për portal kanë pranuar dhe opsionin për të punuar si mësues ndihmës, pasi nga lista e mësuesve me Arsim Special, si nga ZVAP Shkodër edhe nga DRAP Lezhë, thirrjes “Vend vakant për mësues ndihmës”, nuk iu përgjigj, nuk u paraqit asnjë kandidat.

Sa më sipër, Shkolla ka siguruar mbështetjen e nevojshme për të zhvilluar potencialin e nxënësit me aftësi ndryshe. Subjektet ankues kanë qenë gjithnjë të informuar mbi çdo zhvillim në drejtim të zgjidhjes së problemit të të birit të tyre. Shumë shpejt presim emërimin e mësuesit ndihmës në Shkollë, me qëllim ofrimin e mbështetjes së specializuar për këtë nxënë.”

3. Ne vijim te procedurës së shqyrtimit të ankesës kundër Shkollës së Mesme Industriale Shkodër, si dhe ne zbatim te parimit të barazisë së armëve për një proces të drejtë e të paanshem, nëpërmjet e-mailit datë 16.04.2025, palës ankuese i janë dërguar për njohje parashtrimet e depozituara nga ana e Shkollës.

- Nëpërmjet e-mailit datë 22.04.2025, drejtuar Komisionerit, pala ankuese ka dërguar bashkëlidhur prapësimet përkatëse, si vijon:

“...Nga përmbajtja e shkresës nuk rezulton të jenë trajtuar në mënyrë të qartë shkaqet dhe arsyet që më kanë shtyrë t’i drejtohem institucionit tuaj për diskriminim. Gjithashtu në shkresë nuk citohet asnjë dokument zyrtar me numër protokolli dhe datë që të dëshmojë se kur është bërë kërkesa për mësues ndihmës. Nga se rezulton në dokumentacion, mësuesi ndihmës është vënë në dispozicion vetëm pas ankesës sime në platformën e bashkëqeverisjes, dhe jo me iniciativën e drejtorit të shkollës...”

4. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj anese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 346/5 prot., datë 02.05.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Palëve u është bërë e ditur se mund të depozitojnë gjatë seancës dëgjimore fakte e prova që mbështesin qëndrimin e pretendimet e tyre respektivisht, dhe që nuk janë paraqitur deri në këtë moment të procedurës hetimore, pranë KMD-së.

Senca dëgjimore u zhvillua me datë 29.05.2025, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit, në mungesë të palës ankuese⁶ dhe me praninë e titullarit (Drejtorit) të Shkollës së Mesme Industriale Shkodër, në tagrin e përfaqësuesit ligjor të saj.

Drejtori i Shkollës, në deklaratimet gjatë seancës u ka qëndruar në thelb deklaratimeve të depozituara shkresërisht para KMD-së, duke theksuar se:

“Për faktin se fëmija O. V është me aftësi të kufizuara, ne si Shkollë jemi vënë në dijeni nëpërmjet platformës SMIP, dhe as nga prindi, as nga dikush tjetër. Që në këtë moment kemi filluar procedurat për kërkimin e sigurimit të mësuesit ndihmës, pasi më herët Shkolla nuk ka pasur fëmijë me AK, të regjistruar.

Kemi telekamerat që tregojnë qartë kujdesin e veçantë të Shkollës ndaj fëmijës, prandaj gjykoj se pretendimi i palës ankuese është i pabazuar. Fëmija ka pasur në dispozicion thuajse 6 mësues. AKPA ka vendosur si kriter që një mësues për fëmijët me AK duhet të ketë formimin përkatës për AK.

⁶ Nëna e fëmijës, znj. A. C ka njoftuar nëpërmjet e-mailit datë 28.05.2025, se e ka të pamundur të paraqitet në seancë për arsye shëndetësore dhe se mbeten në pritje të vendimit të KMD-së.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

Ndryshimet në strukturën e Shkollës nuk bëhen në mes të vitit, por në fillim të vitit kalendarik. Organigrama del me urdhër të Ministrit përgjegjës. Aktualisht që flasim ne kemi një mësues ndihmës për fëmijën O.

Më përpara, janë angazhuar për të punuar me fëmijën disa mësues të Shkollës, pavarësisht se nuk kishim një mësues ndihmës të posaçëm për nxënësin O. V. Programet për fëmijën janë bërë sipas programave të hartura nga psikologu i Shkollës. Mësuesi kujdestar i nxënësit del me një raport mujor për ecurinë e progresin e fëmijës, po ashtu dhe mësuesi ndihmës (aktualisht).

Në degën që ka zgjedhur nxënësi, sipas raporteve përkatëse ai manifeston vështirësi. Theksoj se edhe vetë fëmijët kanë qenë një mbështetje për O.

Për të marrë mësuesin ndihmës për nxënësin O. V kemi intervistuar mbi 100 kandidatë për mësuese ndihmës, pasi kandidatët janë tërhequr vazhdimisht. Theksoj se DRAP Lezhë ka gjithsej 13 mësues me formim të posaçëm të kësaj natyre, pra të specializuar, dhe asnjë kandidat nuk ka pranuar të vijë, deri sa u dakordësuam me mësuesin aktual, me të cilin nënshkruam kontratën e punës.”

Lidhur me situatën e prezantuar nga prindërit ndodhur me datë 11.12.2024, është depozituar një proceverbal i takimit të mbajtur me praninë e disa prej nxënësve të klasës ku ndjek procesin mësimor O, si dhe Raporti psikologjik i hartuar e nënshkruar nga psikologjia e Shkollës E. L, në të cilin evidentohet se:

“Më datë 11.12.2024, gjatë një ore të zakonshme mësimore, klasa ishte e angazhuar në një aktivitet mësimor që përfshinte ndërveprim dhe pjesëmarrje të lartë nga nxënësit. Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, niveli i zërit dhe zhurma në klasë u rrit, çka ndikoi negativisht te nxënësi me çrregullim të spektrit autik, i cili është i ndjeshëm ndaj stimujve të tillë.

Gjatë bisedës së lirë mes nxënësve në kontekstin e temës së orës, u përmend fjala “sferë”, një fjalë që. Më rastin e nxënësit në fjalë, është e lidhur me përjetime shqetësuese dhe vepron si një stimul negativ i njohur më parë.

Kjo solli një reagim emocional nga ana e tij, që u manifestua përmes acarimit dhe shqetësimit të dukshëm. Është e rëndësishme të theksohet se nuk pati asnjë veprim me qëllim ngacmimi apo përjashtimi nga ndonjë nxënës i klasës. Reagimi i nxënësit ndodhi si pasojë e ndejshmërisë së tij specifike dhe kushteve mjedisore (zhurma dhe fjalë “sferë” e përmendur.

Ditën e nesërme, me datë 12.12.2024, u zhvilluan takime individuale dhe në grup me disa nxënës të klasës për të kuptuar më mirë dinamikën e situatës. Nga këto biseda rezultoi se:

- *Incidenti nuk ishte qëllim ngacmimi apo përjashtimi ndaj nxënësit O.*
- *Sjellja e zhurmshme dhe enrgjia e lartë në klasë pas një ore të mëparshme kanë ndikuar atmosferën në klasë.*
- *Nxënësit shpehën mirëkuptim dhe kujdes ndaj shokut të tyre me autizëm.*

U organizua një orë ndërgjegjësuuese, edukative dhe informuese me të gjithë klasën, me qëllim informimin për çrregullimin e spektrit autik, mënyrat e përfshirjes pozitive, mirëkuptimit dhe respektimit të dallimeve individuale.

U theksua rëndësia e një klime të qetë e të parashikueshme, e cila ndihmon të gjithë nxënësit, në veçanti ata me nevoja të veçanta.

U inkurajuan nxënësit të tregojnë ndjeshmëri dhe të shmangin përdorimin e termave apo sjelljeve që mund të shkaktojnë reagime emocionale të bashkëmoshatari i tyre, pavarësisht se nuk janë me qëllim keqdashës...

Gjatë seancës dëgjimore, u depozitua në cilësi prove dokumentacioni respektiv, si: Procesverbali mer. 5 prot., datë 09.09.2024 “Komisioni për nxënësit me Ak” dhe përbërja e tij, Plani Edukativ Individual (PEI) i hartuar prej Komisionit të AK në Shkollë (nënshkruar dhe nga prindi i fëmijës A. C, PEI mujore të nxënësit dhe raporti Psiko-Edukativ i hartuar nga psikologjia e Shkollës.

Regjistrimi i nxënësve në klasën e X-të, në arsimin e mesëm profesional në IAP, për vitin shkollor 2024-2025, (respektivisht rastit në fjalë), është bazuar në parashikimet e akteve të mëposhtme ligjore dhe nënligjore. Kështu:

Urdhri i përbashkët me nr. 193, datë 30.04.2024 “ Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar”, i MAS-së dhe MEKI-t, në pikën 3/a, të tij, ka përcaktuar se: “Në arsimin profesional mësimet fillojnë më datë 9 shtator 2024”.

Urdhërimi i përbashkët me nr. 13, datë 10.07.2024 “ Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar”, i MAS-së dhe MEKI-t, ka në objekt të tij përcaktimin e masave dhe veprimtarisë që ndërmarrin insitucionet e sistemit arsimor parauniversitar gjatë vitit shkollor 2024-2025.

Në pikën 2, të këtij Udhëzimi, përcaktohet se: “Regjistrimet dhe transferimet e nxënësve në insitucionet e arsimit parauniversitar (IAP) të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me procedurat e përcaktuara në Urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023, të MAS-it “Për miratimin e rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)”.

Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP)⁷, më datë 8 korrik 2024, janë publikuar afatet për regjistrimin e nxënësve në IAP, duke cituar si më poshtë vijon:

“Në zbatim të Urdhrit nr 300 dt 19.06.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për disa ndryshime të urdhrin nr. 31, datë 28.01.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë”, urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023 “Për miratimin e rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar”, ligjit nr. 44, datë 15.06.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, urdhrin nr. 137 dt.08.07.2024 “Për përcaktimin e afateve të regjistrimeve të

⁷ <https://arsimiparauniversitar.gov.al/njoftim-per-hapjen-e-regjistrimeve-te-nxenesve-per-vitin-shkollor-2024-2025/>

nxënësve”, njoftojmë hapjen e aplikimeve për regjistrim në shkollë për vitin shkollor 2024-2025, si më poshtë:

Urdhër “Për përcaktimin e afateve të regjistrimeve të nxënësve”

Aplikimi për regjistrim të nxënësve në klasë të dhjetë në gjimnaz ose shkollë të mesme të orientuar për vitin shkollor 2024-2025, kryhet online në portalin e-albania në shërbimin “Regjistrimi në klasë të dhjetë” nga prindi/kujdestari ligjor i fëmijës, në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=10118

Aplikimi për regjistrim në klasën e parë dhe klasën e dhjetë në gjimnaz ose shkollë të mesme të orientuar mund të bëhet duke filluar nga data 08 korrik 2024 deri më datë 31 gusht 2024 ora 23:59.”

Udhëzimi nr. 13, datë 13.04.2022 “Për mësuesin ndihmës dhe ngritjen e funksionimit të komisionit për nxënës me AK, në Institucionet Publike të Arsimit Profesional”, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përcakton rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e mësuesit ndihmës, ngritjen dhe funksionimin e komisionit për nxënës me AK, në institucionet publike të arsimit profesional.

Në nenin 4, të këtij Udhëzimi përcaktohet se: “Pranë çdo institucioni të arsimit profesional ngrihet me Urdhër të Drejtorit të këtij institucioni, Komisioni i AK, i cili vlerëson nevojat për asrim dhe trajnim profesional të nxënësit me AK...”

Udhëzimi përcakton funksionimin, detyrat e Komisionit, kriteret për përzgjedhjen e mësuesit ndihmës, procedurën për përzgjedhjen e tij, si dhe detyrat e mësuesit ndihmës.

Bazuar në aktet e mësipërme rregullatore, caktimi dhe përfshirja e mësuesit ndihmës në institucionin arsimor të mesëm profesional, bëhet përmes miratimit të tij në strukturën e këtij institucioni, strukturë e cila miratohet nga ministri përgjegjës për AFP⁸.

Lidhur me kronologjinë e veprimeve të Shkollës, të ndjekura në kontekst të emërimit të një mësuesi ndihmës për nxënësin O. V, pas regjistrimit të tij në këtë Shkollë evidentohen si vijon:

- Nisur nga afatet e mësipërme për regjistrimin e nxënësve të klasës së X-të, në shkollat e mesme të orientuara (Nga data 8 korrik 2024 – 31 gusht 2024), evidentohet se, Shkolla Mesme Profesionale “Arben Broci”, Shkodër, ku është regjistruar nxënësi O. V (nëpërmjet platformës online SMIP), pas menaxhimit të dokumentacionit përkatës për regjistrimin e tij, ka ardhur në dijeni të faktit se nxënësi është me AK dhe se në arsimin bazë ka qenë i asistuar me mësues ndihmës.

⁸ Arsimit dhe Formimit Profesional

- Nëpërmjet e-mailit datë 04.09.2024⁹, Drejtori i Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci”, Shkodër, i është drejtuar strukturave përgjegjëse të AKPA-së, duke i informuar si më poshtë citohet:

“Ju informoj se në Shkollë kam një regjistrim me PAK, në drejtim TIK, ku nxënësi si më poshtë... xxxxxxxxxx... është trajtuar që në shkollë fillore me mësues ndihmës.

Ju lutem të shikohet mundësia që me fillimin e vitit shkollor 2024-2025, të kem mundësinë që të përdor një nga dy vendet e mësuesit profesional për të rekrutuar një mësues ndihmës...”

- Me procesverbalin nr. 5, datë 0.09.2024, të Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci”, Shkodër, është ngritur Komisioni për nënësit me AK”, i cili ka hartuar dhe PEI, që duheshin ndjekur për nxënësin me AK.
- Me e-mailin datë 19.09.2024, AKPA, i drejtohet Drejtorit të Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci”, Shkodër, me përmbajtjen:

“Gjeni bashkëlidhur draft-strukturën e Shkollës tuaj për vitin shkollor 2024-2025. Lutemi konfirmimin tuaj për strukturën e re të propozuar, gjithashtu edhe për numrin e mësuesve me kohë të pjesshme, që nga 3 do të bëhet 2.”

- Nëpërmjet e-mailit datë 20.09.2024, Drejtori i Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci”, Shkodër, i përgjigjet AKPA-së si vijon:

“Jam dakord me ndryshimet në Organigramë, por nuk shoh shtesë me mësues ndihmës për fëmijën me AK që është regjistruar në vitin e parë TIK, pasi nxënësi ka qenë i asistuar në çdo vit në shkollën ku ka mbaruar arsimin bazë. Si mund të veprojmë¹⁰? Njoftimin për këtë rast e kam dërguar me datë 4 shtator 2024, në ora 16:41.”

Me Urdhrin nr. 278, datë 28.02.2025, të Ministrit të MEKI-t, Shkollës iu miratua një mësues ndihmës në strukturën organizative.

Në vijim të procedurave për rekrutimin e mësuesit ndihmës, me datë 17.03.2025, është arritur të nëshkruhet marrëveshja me një nga mësuesit ndihmës, sipas listave të dërguara nga ZVAP me kandidatët e profileve të tjera, të cilët gjatë aplikimit për portal kanë pranuar edhe opsionin për të punuar si mësues ndihmës, pasi nga lista e mësuesve me arsim specila si nga ZVAP Shkodër edhe nga DRAP Lezhë, thirrjes “Vend vakant për mësues ndihmës” nuk iu përgjigj asnjë kandidat.

- Me shkresën me nr. 63/1 prot., datë 17.03.2025, me lëndë: “Emërim në detyrë”, z. M . emërohet në pozicionin Mësues Ndhmës, me kohëzgjatje punësimi deri në datën 30.06.2025.(Emërimi i mësuesit M . është i pasqyruar në strukturën e re (Organigramën e shkollës për vitin 2024-2025)

⁹ Ditën e mërkurë

¹⁰ Prindi me shkresën e datës 17.09.2024 i është drejtuar Shkollës me kërkesë për mësues ndihmës për fëmijën e tyre.

Pas seancës dëgjimore, Drejtori I Shkollës, z. Z. L, ka depozituar nëpërmjet e-mailit shkresën me nr. 144 prot., datë 18.07.2025 me lëndë: “Ndryshim kontrate”, nëpërmjet të cilës, konstatohet se z. M. M, i emëruar në pozicionin Mësues Ndhmës (sipas Urdhrit nr. 278, datë 28.02.2025, i ndryshohet kohëzgjatja e marrëdhënive të punës, në punësim pa afat, me kushtin që Shkollë të ketë të regjistruar fëmijë me AK.

Për gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e Shkollës janë ndjekur të gjithë hapat procedural, konform parashikime në aktet e mësipërme, dhe se, nuk konstatohet që ajo, të jetë në shkelje të dispozitave ligjore, përse ka tagër Shkolla të veprojë e procedojë në rastin në fjalë (lidhur me përgjegjësitë e kompetencat e saj për caktimin e mësuesit ndihmës për nxënësin me AK). Veprimet e sjellja e Shkollës janë në përputhje me kompetencat e saj si dhe me parimin e respektimit të ineteresit më të lartë të fëmijës dhe së drejtës së tij për trajtimin dinjitoz dhe gjithëpërfshirës në Shkollë.

Në këtë kontekst, duke iu rithyer rrethanave konkrete të çështjes, Komisioneri vlerëson se, kërkimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkon të arrijë ose të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi (me nr. 51 regj/2025) dhe fillimit të kësaj procedure administrative është përmbushur, nëpërmjet miratimit të kohëzgjatjes së marrëdhënive të punës, në punësim pa afat, për mësuesin ndihmës të emëruar, për asistimin e nxënësit O. V, përgjatë gjithë periudhës (viteve, kohëzgjatjes) së studimeve të tij pranë kësaj Shkolle.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar përcaktohet: “3. *Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*”

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.*

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat efektive konkrete të ndërmarra në më pak se 3 javë nga paraqitja e ankesës pranë KMD-së,
- Përmbushjen e qëllimit për të cilin ishte iniciuar ankesa konkrete, në funksion të interesit më të lartë të nxënësit O. V, duke konsideruar të drejtën e siguar për asistim nga mësuesi ndihmës edhe përgjatë vijimësisë së studimeve të tij, deri në përfundim të tyre, (dhe jo vetëm për vitin shkollor objekt ankese);
- Qëllimin parandalues të LMD-së, ndërgjegjësimin e ndërmjetësimin për zgjidhje miqësore e zbatim efektiv të tij, dhe jo vetëm karakterin konstatues dhe ndëshkues të vendimmarrjeve të KMD-së;

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 51 regjistri, datë 28.02.2025, të paraqitur nga prindërit e nxënësit O. V, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur¹¹.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar (LMD), ku përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”; si dhe sa më sipër analizuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në respektim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe interesit më të lartë të fëmijës/nxënësit, rekomandon MEKI-n, duke pasur në vëmendje gjetjet e këtij Vendimi, të marrë masat paraprake në kohë, lidhur me miratimin e strukturave të IAP-ve, për shtimin në organigramat e tyre të mësuesit ndihmës, për nxënësit me AK, kur është e nevojshme, për t’u siguruar atyre të drejtën efektive, për arsimim në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme sipas përcaktimeve përkatëse ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarohet të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 51 regjistri, datë 28.02.2025, të paraqitur nga prindërit e nxënësit O. V, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

¹¹ Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 107/2024, Nr. 181/2024, Nr. 2, datë 06.01.2025.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

2. Rekomandohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, që, në vështtrim të gjetjeve dhe konstatimeve të këtij Vendimi, për vitin shkollor 2025-2026, të marrë masat paraprake në kohë, lidhur me miratimin e strukturave të IAP-ve, për shtimin në organigramat e tyre të mësuesit ndihmës, për nxënësit me AK, kur është e nevojshme, për t'u siguruar atyre të drejtën efektive, për arsimim në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme sipas përcaktimeve përkatëse ligjore.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA